

AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“WhatLindadid” SH.P.K

Sot me date 23.03.2023 :

- Erlinda Hoxhaj, atesia Hysen, shtetas Shqipetar lindur me 16.12.1988 ,ne Corovode Shqiperi , banues ne Tirane, me dokument identifikimi me nr I86216078U;

bazuar, ne legjislacionin ne fuqi vecanerisht, bazuar ne nenet 68 e vijues te ligjit nr. 9901 dt.14.04.2008 «Per Shoqerite Tregtare» i ndryshuar me ligjin nr. 129/2014 , Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 ”Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, LIGJ Nr. 131/2015 PER QENDRËN KOMBËTARE TË BIZNESIT, ne dispozitat e Kodit Civil ne cilesine e ortakeve themelues si dhe ne vullnetin tone te lire te shprehur dhe ne nenshkrimin e akteve te themelimit te shoqerise kemi hartuar aktin e themelimit dhe statutin e nje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar (me poshte shoqeria):

KREU I

THEMELIMI , EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA

NENI. 1

DATA E THEMELIMIT, EMRI I THEMELUESIT

Sot ne date 23.03.2023, u themelua shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emrin

“WhatLindadid” SH.P.K

I. Themeluesit e shoqerise jane :

- Erlinda Hoxhaj, atesia Hysen, shtetas Shqipetar lindur me 16.12.1988 ,ne Corovode Shqiperi , banues ne Tirane, me dokument identifikimi me nr I86216078U;

NENI. 2
OBJEKTI I SHOQERISE

Objekt i kesaj shoqerie do te jete:

Ofrimin e shërbimeve të parukerisë dhe shërbimeve estetike, shitje/blerje me pakice dhe shumice, import dhe ofrimi në treg i produkteve të parukerise, estetike dhe të tjera..

Shoqeria ka te drejte te ushtroje cdo lloj veprimtarie tjeter te lejuar nga ligji dhe ne perputhje me rregullat.

NENI. 3
KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e shoqerise do te jete deri ne nje afat te papercaktuar
Shoqeria mund te prishet perpara ketij afati me vendim te asamblese se Ortakeve.

NENI. 4
SELIA E SHOQERISE

Selia e Shoqerise .eshte ne adresen: Tirane Rruga Hasan Sufa ,Zona Kadastrale Nr. 8150,
Nr. Pasurie 8/45+1-10 Tirane

KREU II
KAPITALI
NENI. 5
KAPITALI I REGJISTRUAR

Kapitali i regjistruar i shoqerise do te jete 100.000(njeqind mije) leke i perbere nga 1 kuota.

Pjesemarrja e ortakut themelues ne kapitalin e shoqerise eshte:

Kontributi ne kapitalin e shoqerise eshte 100.000 leke dhe perbehet nga 1(nje) kuote me vlere nominale te kuotes 100.000 leke nga Ortaku :

Erlinda Hoxhaj, atesia Hysen, shtetas Shqipetar lindur me 16.12.1988 ,ne Corovode Shqiperi,
banues ne Tirane, me dokument identifikimi me nr I86216078U;zoteron 100% te kuotes me vlere 100.000 leke.

Kontributet e ortakëve mund të jenë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/te paluajtshme, apo të drejta).

NENI. 6
ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenskrimeve te pjeseve te kapitalit te regjistruar per kontribute ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin e regjistruar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejat kushte qe kerkohet per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi prek ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqsojne.

NENI. 7
TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo te kalohen si me poshte:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Cdo menyre tjeter percaktuar ne ligj.

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme midis ortakeve.

Pjeset e kapitalit te regjistruar jane te transferueshme me ruge trashegimije, sipas parashikimeve ligjore.

KREU III
ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

NENI. 8
ORGANET VENDIMARRESE

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmares i shoqerise.

Asambleja e pergjithshme eshte kompetente per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet si me poshte:

- a. Percaktimi i politikave tregtare te shoqerise
- b. Ndryshimet e statutit
- c. Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- d. Emerimin dhe shkarkimin e likujdatoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
- e. Percaktimi i shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c) e d)
- f. Mbikqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- g. Miratimi,i bilanceve



- h. Zmadhim dhe zvogelim kapitali
 - i. Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
 - j. Perfaqesimin ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
 - k. Riorganizimi dhe prishja e shoqerise
 - l. Miraton rregulla proceduriale te mbledhjeve te asamblese
 - m. Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti
- Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete. Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

NENI 9

THIRRJA E MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortakët jane dakort, per te marre vendime, pavaresisht parregullslse.

NENI 10

KUORUMI

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortakët, qe zoterojne me shume se 30 % te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per tregetaret dhe Shoqerite tregetare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortakët qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese kuorumi i permendur ne paragrafin e mesiper nuk arrihet, asambleja e pergjithshme, mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

NENI 11

MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e pergjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votave te zoteruesve te kapitalit te ortakeve pjesmarres, per ndryshimin e statusit zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres, per ceshtjen te tjera.

Cdo ndryshim duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne regjistrin e shoqerise.

NENI 12

PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendimin pet:

- a) vleresmin e veprimtarise se tij
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij
- c) ngritjen e nje padije ndaj tij nga shoqeria
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja

Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konfikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

NENI 13

ADMINISTRIMI

Asambleja e pergjithshme emerone nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet me te drejte ripertesitje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne QKB.

Personi i mepostem caktohet si Administrator i pare i shoqerise, duke patur te drejta te pakufizuara administrimi:

Erlinda Hoxhaj, atesia Hysen, shtetas Shqiptar lindur me 16.12.1988 ,ne Corovode Shqiperi, banues ne Tirane, me dokument identifikimi me nr 186216078U.

NENI 14

KOMPETENCAT E ADMINISTRATOREVE

Administratoret kane te drejte dhe detyrohen te:

- a) Kryejne te gjitha veprimet e administrimit te vendosura nga asambleja e pergjithshme duke zbatuar politikat tregetare
- b) Perfaqesojne shoqerine
- c) Kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise
- d) PergatIsIn dhe nenshkruajne bilancIn vjetor, bilancIn e konsoliduar dhe raportIn e ecurIse se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, I paraqesin keto dokumente perpara Asamblese se Pergjithshme per miratIm
- e) Krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise
- f) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhena e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit
- g) Raportojne para Asamblese se Pergjithshme nepermjet relacioneve mbi zbatimin e politikave tregetare dhe te veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise



h) Kryejne detyra te tjera te parashikuara nga ligji dhe statuti.

Asambleja e pergjithshme mundet ne cdo moment, te shkarkoje administratorin me shumice te thjeshte te votave. Statuti ose rregullore te tjera nuk mund ta kufizojne ose heqin kete te drejte.

NENI 15

PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

1. Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate admInstrImIt te shoqerise. Administratoret te cilet kane kryer veprIme ose bere marreveshje te pa aprovuara nga asambleja, jane pergjegjes per demet e sjella shoqerise dhe pergjigjen personalisht ose solidarisht per pasojat.
2. Nese administratori vepron ne kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale eshte i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes si dhe ti kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregulta.

KREU IV

VITI FINANCIAR -EKSPERTET

NENI 16

VITI FINANCIAR

Viti finciar i Shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 Dhjetor, Perjashtimisht , viti i pare finciar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB dhe mbyllet me 31 dhjetor.

NENI 17

EKSPERTET

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko-tregtare te shoqerise, dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij, per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve. Ne permbushje te kesaj detyre eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit finciar vjetor si dhe ate per kontrollet periodike te ushtruara.

KREU 5

PRISHJA DHE RI-ORGANIZIMI I SHOQERISE

NENI 18

PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Shoqeria konsiderohet e shperndare kur:

- a. Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar e shoqerise
- b. Me vendimet e asamblese se Ortakeve
- c. Me hapjen e procedurave te falimentit

- d. Nese nuk zhvillon aktivitet tregetar per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 Per Qendren Kombetare te Regjistrimit,
- e. Me vendim gjykate.

NENI 19

RIORGANIZIMI I SHOQERISE

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te ligjit mbi shoqerite tregtare.

ART. 20

KLAUZOLA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Ortaket dhe administratoret e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, nuk mund te mbajne pozicionin drejtues apo te jene te punesuar ne nje shoqeri qe ushtron aktivitet ne te njejten fushe me te paren. Ndalimi i pikes 1 mund te anulohet ne asamblene e pare te pergjithshme me ³/₄ e votave ne sipas dispozitave te neneve 87 dhe 145 te ligjit per shoqerite tregtare.

NENI 21

LEGJISLACIONI

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me statutin, legjislacionin shqiptar dhe ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

NENI 22

MOSMARRVESHJET

Per mosmarrveshjet midis ortakeve te shoqerise, ose shoqerise me te tretet, gjykata kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata Shqiptare.

Ky akt, u redaktua ne 4 kopje ne gjuhen shqipe dhe ne gjuhen italiane, me vlere te njejte ligjore.

ORTAKET THEMELUES

Erlinda Hoxha

